



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

Turizmi kulturor në jug, rindërtohet kisha e Shën Thanasit në Dhërmi. Kumbaro : “Rrugët e besimit, destinacion i turizmit kulturor”

2018-04-14 14:00:00



Vetëm një vit më parë, Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës, në mbledhjen e fundit të Këshillit Kombëtar të Restaurimit miratoi projektin e rindërtimit të Kishës së Shën Thanasit brenda Qendrës Historike të Dhërmiut. Ministrja Kumbaro angazhohej se “Kisha do të rindërtohej ashtu siç ka qenë kur ishte vërtetë një kishë, siç e meriton Shën Thanasi, si e meritojnë banorët e Dhërmiut, si profesorët Aleksander Meksi e Pirro

Thomo e patën studiuar e rilevuar herët”. Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro, mori pjesë në këtë fundjavë në ceremoninë e bekimit të punimeve për rindërtimin e Kishës së Shën Thanasit, Dhërmi.

Vetëm një vit më parë, Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës, në mbledhjen e fundit të Këshillit Kombëtar të Restaurimit miratoi projektin e rindërtimit të Kishës së Shën Thanasit brenda Qendrës Historike të Dhërmiut. Ministrja Kumbaro angazhohej se “Kisha do të rindërtohej ashtu siç ka qenë kur ishte vërtetë një kishë, siç e meriton Shën Thanasi, si e meritojnë banorët e Dhërmiut, si profesorët Aleksander Meksi e Pirro Thomo e patën studiuar e rilevuar herët”.

Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro, mori pjesë në këtë fundjavë në ceremoninë e bekimit të punimeve për rindërtimin e Kishës së Shën Thanasit, Dhërmi.

Ceremonia që shënon një ditë të bekuar për besimtarët ortodoksë, trashëgiminë kulturore dhe banorët e Dhërmiut u bë në javën e shenjtë të ringjalljes së Krishtit. Në ceremoni merrnin pjesë Kryetari i Bashkisë së Himarës, Jorgo Goro, kryeplaku i Himarës, Aleks Marko, banorë, etj.

Kisha e re është ende në themelet e para të ndërtesës, por po ngrihet në të njëjtin vend ku ndodhej e para.

Ministrja Kumbaro u shpreh se: “Jam shumë e nderuar që sot isha pjesë e ceremonisë së bekimit të rindërtimit të Kishës së Shën Thanasit, në javën e shenjtë të ringjalljes së Krishtit. Mbjatëm premtimin e dhënë nga Qeveria shqiptare banorëve të Dhërmiut, dy vjet më parë. Falë punës së përbashkët nga Ministria e Kulturës, Bashkia Himarë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë dhe fshati Dhërmi, treguam se me vullnet të mirë, me dialog e zemër të hapur bëhen punët e mira e të paqme!”.

Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro, ka parë nga afër punimet për rindërtimin e kishës në Dhërmi, duke theksuar se referuar turizmit kulturor në jug të vendit, në fokus mbeten edhe qendrat historike të fshatit Dhërmi dhe Vuno, të bashkisë së Himarës, të cilat do të jenë gati për sezonin turistik të këtij viti.

Bëhet fjalë për një investim rreth 7 milion euro, me qendrën historike të Dhërmiut dhe Vunoit, por edhe kishën e shumpërfolur të Shën Thanasit në Dhërmi, ndërsa synimi mbetet turizmi gjithëvjetor dhe jo vetëm në muajt e verës në jug të vendit.

Kryetari i bashkisë Himarë Jorgo Goro ka theksuar se qëllimi mbetet që zonat historike në jug të vendit dhe kryesisht në bashkinë Himarë të jenë qendra të rëndësishme historike, për një

turizëm jo vetëm në det, por kryesisht në promovimin e kulturës dhe historisë.

Qendra historike e fshatit Dhërmi dhe Vuno, por edhe ndërhyrje të tjera në jug të vendit janë padyshim investime që në jug të vendit synojnë ndryshime të rëndësishme në thithjen e turistëve vendas dhe të huaj, ndërsa krahas detit dhe resurseve të tjera, në fokus mbetet padyshim edhe tuzimi kulturor. Qëllimi mbetet edhe rikthimi i banorëve në këto zona, për të investuar në bashkinë Himarë, me qëllimin rikthimin e turizmit kulturor në jug të vendit.